



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më 2025

V E N D I M

Nr. _____, datë _____. 2025

PËR
“MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR: RREGULLORE “PËR
MONITORIMIN E SPEKTRIT TË FREKUENCAVE”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z. Gentian	Sala	Kryetar
Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
Z. Lorenc	Bako	Anëtar
Z. Bleron	Dokle	Anëtar
Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 14 nëntor 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***“Miratimin e dokumentit përfundimtar: Rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave””.***

BAZA LIGJORE:

1. Gërma “dh”, pika 1, e nenit 12, neni 44 dhe neni 64 i ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin nr. 21, datë 07.12.2021, të Këshillit Drejtues të AKEP.

3. Dispozitat e Radio Rregullores të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU) dhe Udhëzuesit mbi Monitorimin e Spektrit (Handbook on Spectrum Monitoring - ITU).

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti përfundimtar: Projektregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”;
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;
4. Qëndrimi i AKEP mbi komentet e palëve të interesuara, gjatë Këshillimit Publik;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr.15, datë 25.09.2025, ka miratuar dokumentin për këshillim publik, projektregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”.
2. Dokumenti për këshillim publik, projektregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave” u miratua nga AKEP duke u bazuar në përcaktimet e gërmës “dh” të pikës 1 të nenit 12, nenit 44 dhe nenit 64 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton procedurat e monitorimit të spektrit të frekuencave, të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave si dhe procedurave për administrimin e interferencave.
3. Dokumenti për këshillim publik, projektregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, u publikua në faqen zyrtare të AKEP, më datë 25.09.2025, për një periudhë këshillimi publik deri më datë 25.10.2025.
4. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, pranë AKEP u depozituan në rrugë elektronike komente dhe sugjerime nga sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a., dhe “One Albania” sh.a.
5. AKEP, pas marrjes dhe vlerësimit të komenteve të palëve për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, ka përgatitur dokumentin përfundimtar projektregulloren “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”.
6. Dokumenti përfundimtar i AKEP, Rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, përmban:
 - procedurat për monitorimin e spektrit të frekuencave;
 - llojet e stacioneve të monitorimit, planet vjetore/mujore, si dhe bazat e të dhënave.
 - programimin e veprimtarisë së monitorimit dhe raportimi;
 - rregullat teknike, standartet e sigurisë dhe përdorimit të pajisjeve të monitorimit;
 - administrimin e interferencave - procedurat për ankesat, shmangien e interferencave, veprimet e AKEP dhe bashkëpunimin ndërkufitar.

- qëndrimin e AKEP, mbi komentet dhe sugjerimet e palëve të interesuara të dhëna gjatë procesit të këshillimit publik;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikave 1 të neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloren “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky vendim dhe rregullorja “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
3. Rregulloret nr. 44 “Për monitorimin e spektrit të frekuencave” dhe nr. 35 “Për administrimin e interferencave”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka